



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2818/2 prot.,

Datë 16.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Nexia Al Consulting” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83193-10-11-2023, me objekt: “*Sherbim fiskalizimi*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.
- Ankimues:** “Nexia Al Consulting” SHPK, me NUIS L82210031Q, me adresë: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder me adresë: Lagjia 3 Heronjte, rruga Marin Biçikemi, Shkoder

Në datën 15.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2818/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3605 e operatorit ekonomik “Nexia Al Consulting” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83193-10-11-2023, me objekt: “*Sherbim fiskalizimi*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Nexia Al Consulting” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Nexia AI Consulting” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2818 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. OE ka paraqitur furnizime te meparshme me vlere me te ulet se 20% te fondit limit objekt prokurimi. 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. Gjithashtu mund të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing". OE ka paraqitur autorizim prodhuesi per programin J-Billing ne vend te AL Billing..”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro